

VENDIM

Nr. 360, datë 11.5.2016

për

miratimin e rregullave për krijimin dhe administrimin e fondit për shërbimin universal postar dhe mënyrat e përcaktimit të kontributit, në rastin e bashkëfinancimit nga ofruesit e shërbimit universal postar

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 17, të ligjit nr. 46/2015, "Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e rregullave për krijimin dhe administrimin e fondit për shërbimin universal postar dhe mënyrat e përcaktimit të kontributit, në rastin e bashkëfinancimit nga ofruesit e shërbimit universal postar, sipas shtojcës bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

SHTOJCË

RREGULLA PËR KRIJIMIN DHE ADMINISTRIMIN E FONDIT PËR SHËRBIMIN UNIVERSAL POSTAR DHE MËNYRAT E PËRCAKTIMIT TË KONTRIBUTIT, NË RASTIN E BASHKËFINANCIMIT NGA OFRUESIT E SHËRBIMIT UNIVERSAL POSTAR

Neni 1

Objekti

Ky dokument ka si objekt përcaktimin e rregullave për krijimin dhe administrimin e fondit të shërbimit universal postar dhe mënyrat e përcaktimit të kontributit, në rastin e bashkë-financimit nga ofruesit e shërbimit universal postar.

Neni 2

Parime të përgjithshme

1. Shërbimi universal postar është shërbim me interes të përgjithshëm ekonomik për publikun.
2. Kompensimi për koston neto të shërbimit universal postar bazohet në parimet e objektivitetit, mosdiskriminimit dhe proporcionalitetit.
3. Kompensimi për koston neto të shërbimit universal postar nuk duhet të krijojë deformime të konkurrencës në treg.

Neni 3

Termt e përdorur

Termt e përdorur në këtë dokument kanë të njëjtin kuptim me ato të dhëna nga ligji "Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë", dhe ligji "Për ndihmën shtetërore".

Neni 4

Përcaktimi i koston neto

Kostot neto për ofrimin e shërbimit universal postar llogariten si diferencë ndërmjet koston neto për sigurimin e këtij shërbimi dhe kostove që ofruesi i shërbimit universal postar do të kishte pasur nëse nuk do të ishte ofrues i shërbimit universal postar, bazuar në rregullat e përcaktuara dhe të miratuara nga AKEP-i, në zbatim të ligjit nr. 46/2015, "Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë".

Neni 5

Kompensimi i shërbimit universal postar

E drejta e kompensimit për koston neto të ofruesit të shërbimit universal postar lind atëherë kur AKEP-i, pas verifikimit të kryer sipas ligjit nr. 46/2015, "Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë", arrin në përfundimin se ofrimi i shërbimit universal postar shkakton kosto neto shtesë, që përbën një ngarkesë të padrejtë financiare për ofruesin e shërbimit universal postar.

Neni 6

Mënyrat e kompensimit

Mënyrat e kompensimit për koston neto të shërbimit universal postar janë:

- a) kompensimi me fonde publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën shtetërore;
- b) krijimi i fondit të kompensimit me bashkëfinancim të ofruesve të shërbimit postar dhe administrimi i fondit nga AKEP-i;
- c) Kombinimi i shkronjave "a" dhe "b" të këtij neni, në rastet kur aplikimi vetëm i një mekanizmi nuk është i mjaftueshëm për mbulimin e kostove neto të shërbimit universal.

Neni 7

Kompensimi me fonde publike

1. AKEP-i, në përfundim të analizës, i përcjell ministrit përgjegjës për shërbimet postare raportin e vlerësimit për koston neto të shërbimit universal postar për vijimin e procedurës me Komisionin e Ndihmës Shtetërore, sipas legjislacionit në fuqi për ndihmën shtetërore.
2. Ministri i propozon Komisionit të Ndihmës Shtetërore mbulimin e koston neto të shërbimit universal postar në një nga format/mënyrat e përcaktuara në ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, "Për ndihmën shtetërore", të ndryshuar.
3. Zbatimi i kompensimit me ndihmë shtetërore për ofrimin e shërbimit universal postar do të kryhet vetëm pas miratimit nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore.
4. Me marrjen e vendimit të Komisionit të Ndihmës Shtetërore, ministri i përcjell AKEP-it vendimin dhe i kërkon, sipas rastit, krijimin e fondit të kompensimit me bashkëfinancim.

Neni 8

Kompensimi me bashkëfinancim

1. Në rastin e aplikimit të bashkëfinancimit të kostove neto të shërbimit universal nga ofruesit e shërbimit postar, AKEP-i krijon fondin e kompensimit nga të ardhurat e operatorëve postarë, duke hapur një llogari të veçantë bankare dhe duke mbajtur një regjistër të veçantë kontabël.
2. AKEP-i krijon fondin e kompensimit me bashkëfinancim, nëse kjo është e nevojshme, pas vendimit të Komisionit të Ndihmës Shtetërore, sipas përcaktimeve të pikës 7, të nenit 16, të ligjit nr. 46/2015, "Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë".
3. Fondi i kompensimit krijohet nga kontributet e ofruesve të shërbimit postar, bazuar në ndarjen e llogarive, për të evidentuar të ardhurat që vijnë nga shërbimet postare si zë më vete dhe të ndara nga të ardhurat që vijnë nga aktivitete të tjera të biznesit.
4. Kontributi i secilit prej ofruesve të shërbimit universal postar duhet të jetë në proporcion me të ardhurat e përfituara nga ofrimi i shërbimit universal postar dhe nga ofrimi i shërbimeve të tjera alternative. Kontributi i një ofruesi të shërbimit postar përcaktohet me vendim të AKEP-it.
5. Kontributi për fondin e shërbimit universal nga çdo ofrues duhet të jetë deri në 1% e të shumës së të ardhurave vjetore të ofruesit të shërbimit postar.
6. Nëse kontributi i një ofruesi të shërbimit universal postar në fondin e kompensimit është më i vogël se kompensimi i llogaritur për ofrimin e shërbimit universal postar, atëherë ky ofrues i shërbimit universal postar nuk do të kontribuojë në fondin e kompensimit.
7. AKEP-i llogarit shumën e kontributit të secilit ofrues të shërbimeve postare në fondin e kompensimit me bashkëfinancim, mbi bazën e koston neto dhe të parimit të proporcionalitetit, bazuar në të ardhurat dhe pjesët përkatëse të tregut të ofruesve të shërbimit universal postar.

Neni 9

Administrimi i fondit të krijuar me bashkëfinancim

1. Fondi i kompensimit të krijuar me bashkëfinancim të ofruesve të shërbimit universal postar administrohet nga AKEP-i. Ky fond nuk mund të përdoret për qëllime të tjera dhe, nëse nuk shpenzohet, akumulohet dhe mbartet në vitin pasardhës.
2. Shuma për kompensimin e shërbimit universal postar auditohet në bazë vjetore nga një grup ekspertësh kontabël të autorizuar nga AKEP-i.

Neni 10

Kompensimi i kostos neto në mënyrë të kombinuar

1. Kur detyrimi për shërbimin universal postar kërkon zgjerim të infrastrukturës së pikave të aksesit të rrjetit postar, për kompensimin e kostos neto të shërbimit universal postar mund të aplikohet mekanizmi i kombinuar, sipas shkronjës "c", të nenit 6, të këtij dokumenti.
2. Mbulimi i kostos neto me ndihmë shtetërore, në këtë rast, do të bëhet në nivelin e lejuar në legjislacionin për ndihmën shtetërore, të ndryshuar. Pjesa tjetër e kostove për përmbushjen e detyrimit të shërbimit universal do të mbulohet me bashkëfinancim të ofruesve të shërbimit postar.
3. Në rastin e detyrimeve të shërbimit universal, që lidhen me zgjerimin e infrastrukturës së pikave të aksesit në rrjetin postar, AKEP-i mund të përcaktojë detyrimin për financim të shërbimit universal edhe ndaj ofruesit të shërbimit postar, sipas nenit 20, të ligjit nr. 46/2015, "Për shërbimet postare në Republikën e Shqipërisë".